

VENDIM

Nr. 953, datë 25.11.2015

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, TË PËRZGJEDHUR NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pikat 1 e 3, e 18, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat, si më poshtë vijon:

- a) Znj. Ines Muçostepa, kryetare e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë; Fletorja Zyrtare Viti 2015 – Numri 206 Faqe|13322;
- b) Z. Silvio Pedrazzi, drejtor Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank;
- c) Z. Andi Ballta, drejtor Ekzekutiv i shoqërisë “Tranzit”, sh.a.;
- ç) Z. Luan Bregasi, President i Biznes Albania.

2. Vendimi nr. 888, datë 3.11.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama